

Važna napomena: Prevod ovog propisa, odnosno akta sa srpskog jezika na albanski jezik, omogućila je Misija Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju u Republici Srbiji (dalje: Misija OEBS u Srbiji) sa ciljem da se pripadnicima i pripadnicama nacionalne manjine, čiji je jezik u službenoj upotrebi u Republici Srbiji, omogući da se na svom jeziku i pismu obaveste i upoznaju sa sadržinom teksta propisa, odnosno akta koji je predmet ovog prevoda.

Misija OEBS u Srbiji posebno napominje da je isključivo i jedino pravno-relevantan i merodavan tekst propisa, odnosno akta (koji je predmet prevoda u ovom dokumentu) koji je objavljen na srpskom jeziku, u skladu sa i shodno propisu koji uređuje objavljivanje zakona i drugih propisa i akata u Republici Srbiji.

Za potrebe prevoda ovog propisa Misija OEBS u Srbiji angažovala je kompaniju Eurotranslate d.o.o. koja je u celosti, i u svemu prema pravilima struke, odgovorna i garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda na albanski jezik. Misija OEBS u Srbiji ni po jednom osnovu nije odgovorna i ne garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda.

Shënim i rëndësishëm: Përkthimin e kësaj dispozite, respektivisht akti nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, e ka mundësuar Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: Misioni i OSBE-së në Serbi) me qëllim që pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorimi zyrtar në Republikën e Serbisë, t'ua mundësojë që në gjuhën dhe shkrimin e tyre të informohen dhe të njihen me përmbajtjen e tekstit apo dokumentit, i cili është objekt i këtij përkthimi.

Misioni i OSBE-së në Serbi, në veçanti tërheq vërejtjen se teksti i rregullores, është ekskluzivisht teksti i vetëm ligjor-relevant dhe kompetent, respektivisht i aktit (i cili është objekt i përkthimit në këtë dokument), i cili është botuar në gjuhën serbe, në përputhje me dhe në pajtim me dispozitën që përcakton shpalljen e ligjit dhe dispozitave dhe akteve tjera në Republikën e Serbisë.

Për nevojat e përkthimit të kësaj dispozite, Misioni i OSBE-së në Serbi ka angazhuar kompaninë Eurocontract sh.p.k. e cila në tërësi, dhe sipas të gjitha rregullave të profesionit, është përgjegjëse për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë në gjuhën shqipe. Misioni i OSBE-së në Serbi për asnjë arsye nuk është përgjegjës dhe nuk garanton për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë.

Në bazë të nenit 3, paragrafi 6 i Ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare („Fletorja zyrtare e RS”, nr.72/09, 20/14 – GJK dhe 55/14),

ministrja e administratës shtetërore dhe e vetëqeverisjes vendore e miraton

RREGULLOREN

PËR MËNYRËN E REGJISTRIMIT DHE TË MBAJTJES SË REGJISTRIT TË KËSHILLAVE KOMBËTARE

Neni 1

Me këtë rregullore më hollësisht rregullohet mënyra e regjistrimit në Regjistër të këshillave kombëtare (në tekstin e mëtejme: Regjistri), mënyra e regjistrimit të ndryshimeve të të dhënave të cilat janë regjistruar në Regjistër, mënyra e mbajtjes së Regjistrit dhe përmbajtja dhe pamja e fletëregjistrimit në Regjistër.

Neni 2

Regjistri mbahet në formë të librit me lidhje të fortë edhe si bazë elektronike e të dhënave.

Regjistri në formën me shkrim dhe elektronike duhet të përmbajë të dhënat identike.

Neni 3

Regjistri i cili mbahet në formë të librit me lidhje të fortë ka format horizontal dhe përbëhet nga 100 fletë të njëjta të regjistrimit të punuara në letër me ngjyrë të bardhë.

Fleta e regjistrimit përbëhet nga dy faqe të lidhura reciprokisht nga të cilat secila e ka madhësinë 400x300 mm.

Fletëregjistri përmban shtyllën vertikale në të cilën shënohet:

- 1) numri rendor i regjistrimit;
- 2) emërtimi i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare;
- 3) selia dhe adresa e këshillit kombëtar e pakicës kombëtare;
- 4) data e mbajtjes së seancës konstitutive e këshillit kombëtar e pakicës kombëtare;
- 5) emri dhe mbiemri, vendbanimi dhe numri unik i amzës i kryetarit të këshillit kombëtar i pakicës kombëtare;
- 6) data e miratimit të statutit të këshillit kombëtar i pakicës kombëtare, përkatësisht i ndryshimeve dhe plotësimeve të tij;
- 7) numri dhe data e miratimit të aktvendimit për regjistrim në Regjistër;
- 8) numri dhe data e miratimit të aktvendimit për ndryshimin e të dhënave në Regjistër;
- 9) numri dhe data e miratimit të aktvendimit për shpërndarjen e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare;
- 10) numri dhe data e miratimit të aktvendimit për formimin e organit të përkohshëm të administrimit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare;

11) Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për shlyerjen e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare nga Regjistri;

12) shënim.

Pamja e listës së regjistrit (Shtojca 1), është shtypur me këtë rregullore dhe e përbën pjesën përbërëse të saj.

Neni 4

Në kopertinë dhe në faqen e parë të panumërtuar të Regjistrit – librit nga neni 3 i kësaj Rregulloreje është shtypur emërtimi i Regjistrit-librit: "Regjistri i këshillave kombëtare" dhe numri rendor i librit.

Faqja e parë e panumërtuar e Regjistrit – librit vërtetohet me nënshkrim të nëpunësit të autorizuar shtetëror dhe me vulë të ministrisë në fushëveprimin e së cilës janë çështjet e të drejtave të njeriut dhe të pakicave (në tekstin e mëtejme: Ministria).

Neni 5

Shënimi i të dhënave në Regjistër bëhet në shtyllën përkatëse të fletëregjistrit.

Të dhënat në Regjistër shënohen pastër dhe nuk mund të fshihen ose të korrigjohen.

Neni 6

Gabimet më të vogla korrigjohen duke ua hequr vizë një vizë horizontalisht dhe duke e vënë nënshkrimin e nëpunësit të autorizuar shtetëror dhe datën e korrigjimit. Nëse bëhet fjalë për numër më të madh të gabimeve tërë regjistrimi anulohet duke i hequr vizë fletëregjistrimit me një vizë tërthorazi të kuqe dhe regjistrimi bëhet në faqen e parë të lirë.

Neni 7

Nëse hapësira për shënimin e të dhënave në shtyllë përkatëse nuk mjafton, kjo e dhënë regjistrohet në faqen e parë të lirë të regjistrit. Në këtë faqe barten të gjitha të dhënat e fundit të shënuara nga shtyllat e tjera e faqes së regjistrit. Pasi që bëhet kalimi i të të dhënave nga lista e mëparshme e regjistrit, kësaj faqeje i hiqet një vizë tërthorazi me ngjyrë të kuqe.

Në faqen e re të regjistrimit plotësohet edhe shtylla „Shënim” në të cilën shënohet e dhëna për fletëregjistrimin e mëparshëm.

Neni 8

Regjistrimi i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare (në tekstin e mëtejme: këshilli kombëtar) në Regjistër bëhet në bazë të fletëregjistrimit.

Në shtylla përkatëse të fletës së regjistrimit shënohen të dhënat për këshillin kombëtar, si edhe numri dhe data e miratimit të aktvendimit për regjistrim të këshillit kombëtar në Regjistër.

Fletëregjistrimi i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare në regjistër të këshillave kombëtare është shtypur bashkë me këtë rregullore dhe është pjesë përbërëse e saj (Formulari 1).

Neni 9

Me fletëregjistrim në Regjistër paraqiten:

1) procesverbali nga seanca në të cilën është konstituuar legjislatura e parë e këshillit kombëtar;

- 2) dy ekzemplarë të statutit të këshillit kombëtar;
- 3) vendimi për zgjedhjen e kryetarit të këshillit kombëtar;
- 4) fotokopja e vërtetuar e letërnjohtimit të kryetarit të këshillit kombëtar, e nëse ajo nuk e përmban të dhënë për vendbanim dhe adresën edhe vërtetimin për vendbanim;
- 5) dëshmia për pagimin e taksës administrative republikane në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen taksat administrative republikane.

Të dhënat të cilat regjistrohen në formular të fletëregjistrimit të këshillit kombëtar në Regjistër duhet të jenë identike me të dhënat e përmbajtura në aktet dhe dokumentet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 10

Regjistrimi i ndryshimit të të dhënave në Regjistër bëhet në bazë të aktvendimit për regjistrimin e të dhënave në Regjistër, kështu që në shtyllën përkatëse të fletëregjistrimit shënohet numri dhe data e miratimit të aktvendimit për ndryshimin e të dhënave në Regjistër dhe e dhëna e cila ndryshohet.

Njëkohësisht, në shtyllën përkatëse të fletëregjistrimit, menjëherë nën regjistrimin bazë të së dhënës që ndryshohet, përkatësisht regjistrimit të fundit të ndryshimit të kësaj të dhëne të cilës i hiqet vizë me vijë të kuqe të tërthortë, regjistrohet e dhëna e re.

Neni 11

Bashkë me fletëregjistrim për ndryshimin e të dhënave në Regjistër paraqitet:

1) procesverbali nga seanca e këshillit kombëtar në të cilin është miratuar vendimi për ndryshimin e të dhënave, në tekstin origjinal përkatësisht në fotokopjen e vulosur të dokumentit;

- 2) vendimi për ndryshimin e të dhënave;
- 3) dëshmia për ndryshimin e të dhënave;
- 4) dëshmia për pagimin e taksës administrative republikane në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen taksat administrative republikane.

Neni 12

Shlyerja e këshillit kombëtar nga Regjistri bëhet në bazë të aktvendimit për shlyerjen e këshillit kombëtar nga Regjistri, ashtu që në shtyllën përkatëse të fletëregjistrimit shënohet numri dhe data e miratimit të aktvendimit për shlyerjen e këshillit kombëtar nga Regjistri, e pas kësaj fletëregjistrimit që ka të bëjë me këtë këshill kombëtar i hiqen dy viza të kuqe të tërthorta.

Neni 13

Shpërndarja e këshillit kombëtar dhe formimi i organit të përkohshëm të administrimit të këshillit kombëtar bëhet në bazë të aktvendimit për shpërndarjen e këshillit kombëtar dhe aktvendimit për formimin e organit të përkohshëm për administrimin e këshillit kombëtar, ashtu që në shtylla përkatëse të fletëregjistrimit regjistrohet e dhëna për numrin dhe datën e miratimit të aktvendimit për shpërndarjen e këshillit kombëtar dhe numrin dhe datën e aktvendimit me të cilin formohet organi i përkohshëm për administrimin e këshillit kombëtar.

Neni 14

Të dhënat e regjistruara në Regjistër të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare do të shënohen në Regjistër i cili mbahet në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe do të harmonizohen me përmbajtjen e kësaj rregulloreje brenda afatit prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 15

Me ditën e fillimit të aplikimi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare („Fletorja zyrtare e RS”, numër 91/09).

Neni 16

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në „Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë”.

Numër: 110-00-50/2014-17
Në Beograd, më 10 korrik të vitit 2014

Ministrja
dr Kori Udovički d.v.

FLETËREGJISTRIMI NUMËR: _____

Numri rendor i regjistrimit	Emërtimi i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare	Selia dhe adresa e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare	Emri dhe mbiemri, vendbanimi dhe numri unik i amzës i kryetarit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare	Data e mbajtjes së seancës konstitutive e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare	Data e miratimit të statutit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare, përkatësisht e ndryshimeve dhe plotësimeve të tij
1	2	3	4	5	6

Faqja __

Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për regjistrimin në Regjistër	Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për ndryshimin e të të dhënave në Regjistër	Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për shpërndarjen e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare	Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për formimin e organit të përkohshëm të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare	Numri dhe data e miratimit të aktvendimit për shlyerjen e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare nga Regjistri	Shënim
7	8	9	10	11	12

Faqja __

Ministra e administratës shtetërore dhe e
vetëqeverisjes vendore

FLETËREGJISTRIM
PËR REGJISTRIM TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË PAKICËS KOMBËTARE NË REGJISTËR TË
KËSHILLAVE KOMBËTARE

1) Emërtimi i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare

2) Selia dhe adresa e këshillit kombëtar e pakicës kombëtare

3) Kryetari i këshillit kombëtar i pakicës kombëtare (Emri dhe mbiemri)

6) Data e miratimit të statutit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare, përkatësisht e ndryshimeve dhe plotësimeve të tij

Shtojca :

- 1) Procesverbali nga seanca në të cilën është konstituar legjislaturore e parë e këshillit kombëtar të pakicës kombëtare;
- 2) Vendimi për zgjedhjen e kryetarit të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare;
- 3) Fotokopja e vulosur e letërnjohtimit të kryetarit të këshillit kombëtar, e nëse nuk e përmban të dhënë për vendbanim dhe adresën edhe vërtetimin për vendbanim;
- 4) Statuti – dy ekzemplarë;
- 5) Dëshmia për pagimin e taksës administrative republikane në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen taksat administrative republikane.

Në _____
(vendi)

(data)

**Kryetari i Këshillit Kombëtar i pakicës
kombëtare**

(Nënshkrimi)

(emri dhe mbiemri)

